



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Trajnimi i parë online 2026

Tema: “Mbikëqyrja Inspektuese”

28, 29, 30 prill 2026



Qëllimi i Trajnimit

1. Të prezantohen kërkesat ligjore.
2. Të bëhet njoftimi për procesin e Mbikqyrjes Inspektive.
3. Të kuptohen përgjegjësitë dhe rolet gjatë Mbikqyrjes inspektive.

Agjenda

- Baza ligjore,
- Elementet e procesit të inspektimit,
- Kërkesat plotësuese për siguri dhe shëndet, dhe ndikimet mjedisore,
- Shkëmbim i përvojave dhe diskutim.

Baza ligjore për Mbikqyrje Inspektive

- Ligji për Ndërtim 04 / L-110, Neni 29
 - UA 05/2017 për Mbikqyrjen inspektuese dhe lëshimin e CP
 - UA 15/2013 Mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor
- Ligji për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit 08/L – 012.
- Ligji për Produkte të ndërtimit 06/L-033.
- Ligji 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP)
 - Rregullorja 06/2017 Për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtime të përkohshme apo mobile.
 - Rregullore 02/2016 për pajisjet mbrojtëse
 - Rregullore 04/2016 për shenjat e sigurisë

Pjesëmarrësit në projektin ndërtimor

1. Aplikuesi
2. Poseduesi i lejes ndërtimore
3. Projektuesi
4. Kontraktuesi (punëkryesit dhe shërbimet, psh. gjeodezia)
5. Mbikqyrja inspektive
 1. Përfaqësuesit e organit kompetent - Inspektorati
 2. Mbikqyrësit e fazave.
6. Mbikqyrja e masave për siguri dhe shëndetin në punë
 1. Inspektorati Qendror i Punës (www.inspektorati.rks-gov.net)
 2. Koordinatorët për siguri dhe shëndetin në punë.
7. Kërkesa nga MIN&T për produkte ndërtimore
8. Palët tjera (Inspektorët e mjedisit, furnitorët, etj.)

Qëllimi i Mbikqyrjes inspektive të ndërtimit

“Mbikqyrja inspektuese” – inspektim i përputhjes së ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor, kodin e ndërtimit dhe rregulloret teknike në fuqi.

Mbikqyrja inspektuese përfshinë mbikqyrjen periodike të punëve ndërtimore dhe nuk e zëvendëson inxhinierin mbikqyrës të licencuar të fazave përkatëse të ndërtimit;”

(UA 05/2017, f. 2.)

UA 05/2017 Detyrat e inspektorit

- Inspektori pranon dokumentacionin teknik (nga Drejtoria e Urbanizimit),
- Inspektori njoftohet për fillimin e ndërtimit (nga Poseduesi i lejes),
- Inspektori përcjell ndërtimin nga fillimi deri në aplikim për CP,
- Inspektori vërteton përfundimin e punëve dhe kompletimin e dokumentacionit relevant,
- Inspektori përgatit raportin/PV final për dëshmi të përfundimit të punëve,
- Inspektori përcjell raportin e përfundimit te Drejtoria e Urbanizimit.

Elementet dhe procesi i inspektimit në ndërtim

1. Përgatitjet teknike dhe administrative të investitorit dhe palëve të tijë;
2. Protokolet e inspektimit;
3. Përputhshmëria e punimeve me projektin dhe specifikimet teknike;
4. Kontrolli i cilësisë së materialeve dhe ekzekutimit;
5. Aspektet e menaxhimit të progresit, kohës dhe kostos;
6. Dokumentimi dhe raportimi profesional;
7. Procedurat për inspektimet finale dhe lejes së përdorimit.

NXITJA E PROJEKTIT DHE AKTIVITETET FILLESTARE

- Incizimi fillestar gjeodezik i dokumentuar
- Rregullimi i punishtës (UA 05/2017, Rregullorja 06/2017)
- Instalimet e punishtes të përgatitura sipas pëlqimeve
- Plani dinamik (UA 05/2017);
- Poseduesi i lejës ka nënshkruar kontratën me punëkryesin
- Poseduesi i lejës ka siguruar vendimet e duhura për:
 - Udhëheqësin e punëve, dhe
 - Inxhinierët mbikëqyrës të fazave (UA 05/2017);
- Në vend ndërtim janë të gjitha dokumentacionet relevante
- Njoftimi fillestar dhe mbledhja e fillimit

FORMULARI - NJOFTIM PËR FILLIMIN E NDËRTIMIT

Shtojca 1: Njoftim për Fillimin e Ndërtimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

VËREJTJE: Informatat në këtë formular duhet të jenë të sakta dhe para kërkesës për inspektim aplikuesi duhet të konsultohet me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe UA për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, se cilat dokumentacione janë të nevojshme ti këtë në vend ndërtim, apo mund të kërkoj sqarime në inspektoriat.

NJOFTIM PËR FILLIMIN E NDËRTIMIT

A) TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E NDËRTIMIT

1. ADRESA

rruga dhe numri

vendi

2. PARCELA:

Numri i parcelës kadastrale dhe emri i zonës kadastrale të vend ndërtimit

B) TË DHËNAT PËR NDERTIM

- NDERTIM I RI
 MBINDERTIM
 RIPARIM
 RENOVIM
 RRANIM
 TË TJERA

C) A KA NDËRTIM EKZISTUES QË DUHET TË MËNJANOHET?

- PO
 JO

E) TË DHËNAT E POSEDUESIT TË LEJES NDERTIMORE

1. Emri e Mbiemri/Emri i Kompanisë (nëse ka) _____
2. Adresa / Selia: _____
3. Numri i ID-se: _____
4. Nr. Biznesit (për persona juridik): _____
5. Certifikata e Biznesit _____
6. Leja Ndërtimore Nr. _____

F) TË DHËNAT PËR UDHEHEQESIN E VEND NDËRTIMIT

1. Emri e Mbiemri _____
2. Nr. i ID-së: _____
3. Nr.tel. _____

G) TË DHËNAT E PUNEKRYESIT

1. Emri i Kompanisë / Emri dhe Mbiemri (i kontraktorit): _____
2. Selia: _____
3. Nr i ID-se _____
4. Nr.tel. _____
5. Nr. Biznesit _____

H) TË DHËNAT E PROJEKTUESIT

1. Emri e Mbiemri _____
2. Emri i Kompanisë _____
3. Selia _____
4. Nr. i ID-se: _____
5. Nr.tel. _____
6. Nr. Biznesit _____

I) DEKLARATE NE LIDHJE ME LAJMERIMIN

Kërkoj që në një nga mënyrat të më lajmëroni:

- Në adresën e dhënë në lajmërim;
 e-mali adresa: _____; ose
 sms në nr. tel mob. _____

K) TË DHËNAT PER APLIKUESIN (plotësohet nëse aplikuesi nuk është investitori)

1. Emri e Mbiemri: _____
2. Adresa _____
3. Numri i ID-së: _____

Në _____

Poseduesi i lejes/Aplikuesi: _____

Me _____

FORMULARI – Kërkesa për inspektim

Shtojca 3: Kërkesë për Inspektim



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

VËREJTJE: Informatat në këtë formular duhet të jone të sakta dhe para kërkesës për inspektim aplikuesi duhet të konsultohet me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe UA për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, se cilat dokumentacione janë të nevojshme ti këtë ne vend ndërtim, apo mund të kërkoj sqarime ne inspektoriat.

KËRKESË PËR INSPEKTIM

A) TË DHËNAT PËR LEJEN NDËRTIMORE

Nr. i Lejes Ndërtimore

B) TË DHËNAT PËR LOKACIONIN KU DO TË KRYHET INSPEKTIMI:

rruga, numri dhe vendi

C) DATA E KERKUAR PËR INSPEKTIM

Me _____

C) TË DHËNAT PËR LLOJIN E INSPEKTIMIT

inspektim

ri inspektim

D) TË DHËNAT PËR APLIKUESIN E KËRKESËS

emri e mbiemri dhe nr. tel. kontaktues

E) TË DHËNAT PËR UDHËHEQËSIN NË VEND NDËRTIMIT

- 1 Emri e Mbiemri _____
- 2 Nr. i ID-së: _____
- 3 Numri i licencës: _____
- 4 Nr. tel. _____

F) DEKLARATË NË LIDHJE ME KËRKESËN Kërkoj që në një nga mënyrat të më lajmëroni:

- Në adresën e dhënë në kërkesë;
- e-mali adresa: _____; ose
- sms në nr. tel mob. _____.

Në _____

Aplikuesi

Me _____

Protokolet e inspektimit - Formati

Shtojca 2: Inspektimi i Lokacionit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna / Opština / Municipality

Llogo e
Komunës

Logo dhe
njoftim i
përgjiths
hëm

VËREJTJE: Informatat në këtë formular duhet të jene të sakta dhe para kërkesës për inspektim aplikuesi duhet të konsultohet me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe UA për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, se cilat dokumentacione janë të nevojshme ti këtë në vend ndërtim, apo mund të kërkoj sqarime në inspektoriat.

Nr. i vrojtimit të lejes _____

Lista e fazës inspektuese të lokacionit - Protokoll i Inspektimit të lokacionit

INSPEKTIMI I LOKACIONIT

Leja Nr: _____
Adresa: _____
Emri i projektit: _____
Projektuesi: _____
Udhëheqësi i vend ndërtimit: _____
Data e inspektimit: _____

Të dhënat
për
projektin
dhe palët

VËREJTJE: Informatat në këtë listë kontrolli nuk janë gjithëpërfshirëse. Nuk i përfshijnë të gjitha kërkesat e Kodit apo kërkesat e planeve individuale. Kjo listë kontrolluese NUK përfshijon asnjë kërkesë të Kodit.

Nr.	Aprovuar?	PO	JO	N/A
----- PUNËT PËRGADITORE				
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				

Lista e
kontrollit

Komentet:

Hapësira për
komente

<input type="checkbox"/> Aprovohet Ndërtimi plotëson fazën e parë inspektuese	<input type="checkbox"/> Nuk Aprovohet Poseduesi i lejes ndërtimore duhet t'i përmirësoj dhe plotësoj të gjitha vërejtjet dhe mospërpunjet. Deri sa nuk te plotësohen te gjitha permisimet nuk do te behet ri-inspektimi.
<input type="checkbox"/> Aprovohet Nga mos veprimi i organit kompetent (inspektori) ¹	
Nënshkrimi i inspektorit: _____ Nënshkrimi i udhëheqësit të vend ndërtimit: _____	
Data: _____	

Aprovimi,
nënshkrimet, data
dhe deklaratat!

¹ Sipas ligjit për ndërtim neni 31 paragrafi 3. " Në rastin kur inspektori nuk e realizon inspektimin me rastin e përfundimit të ndonjë prej fazave të ndërtimit, poseduesi i lejes e prodhon protokollin mbi përfundimin e asaj faze të ndërtimit, i cili nënshkruhet nga poseduesi i lejes ndërtimore dhe kontraktuesi" duke pasur parasysh pohimin:

"Me nënshkrimin e këtij protokoll, unë betohem dhe pohoj se ky inspektim është kryer për shkak se organi kompetent është kontaktuar dhe nuk është përgjigjur, unë nuk kam bërë asgjë për të ndjellë apo shtrënguar mos përgjigjen nga organi kompetent, protokollin me saktësi pasqyron rezultatet e një inspektimi që ka ndodhur në datën e përmendur më lartë, dhe punët ndërtimore kanë kaluar këtë fazë të inspektimit. Deklaratë në këtë protokoll janë të vërteta dhe të sakta sipas dijenisë sime më të mirë. Kuptoj se çdo falsifikim i këtij protokoll më bën të nënshtrueshëm ndaj dënimeve financiare apo penale"

NENI 10 (UA 05/2017) PROCEDURA KUR INSPEKTORI NUK PËRGJIGJET NË KËRKESËN PËR INSPEKTIM

1. Poseduesi i lejes përgatit protokollin për kompletimin e fazës së ndërtimit.
2. Protokollin së paku do të përmbajë:
 - Aktivitetet e kryera të inspektimit sipas listave përkatëse të inspektimit;
 - Emrin e profesionistit kompetent që ka kryer këtë inspektim;
 - Datën e inspektimit dhe datën kur është dashur të realizohet inspektimi;
 - Fotografi të cilat tregojnë kushtet e punës së inspektuar ndërtimore
 - Pasqyrim të vendndërtimit duke përfshirë punën ndërtimore të inspektuar,
 - Profesionistin kompetent që ka realizuar inspektimin;
 - Nënshkrimin: poseduesi i lejes, kontraktori, dhe ai që kryen inspektimin;
3. Inspektori nuk ka të drejtë të kërkojë ri-inspektim për fazën e kryer nëse nuk i është përgjigjur kërkesës për inspektimin e asaj faze.

PROTOKOLET E INSPEKTIMIT – KAT I

Neni 6 (UA 05/2017) Fazat e inspektimit - Kat I

- Inspektimet bëhen nga organi kompetent në dy fazat vijuese
 - Inspektimi i lokacionit - Shtojca 2
 - Inspektimi final - Shtojca 4/f
- “Për të gjitha fazat tjera të ndërtimit, poseduesi i lejes duhet të sigurojë plotësimin e protokolleve të inspektimit nga inxhinieri përkatës i fazave të ndërtimit.”
- **Për të realizuar ndërtimin në vendpunishte kërkohet Projekti Final.**

PROTOKOLET E INSPEKTIMIT – KAT II

- Fazat e ndërtimit:
 - Inspektimi i Lokacionit - Shtojca 2
 - Inspektimi i punëve ndërtimore nën nivelin e tokës sipas - Shtojca 4/a
 - Inspektimi i elementeve të konstruksionit, mbi nivelin e tokës - Shtojca 4b (Konstruksionet e betonit, metalike, nga druri, dhe muratimet)
 - Inspektimi i instalimeve dhe pajisjeve të vendosura ose instaluara - Shtojca 4/c (Instalimet elektrike, hidroteknike, dhe makinerike)
 - Inspektimi i punëve finale sipas Shtojcës 4/d
 - Inspektimi për siguri nga zjarri sipas Shtojcës 4/e
- **Organi kompetent mund të kërkojë inspektime shtesë**
- Fazat e ndërtimit që nuk janë të aplikueshme mund të përjashtohen.
- Nuk vlen për objektet e trashëgimisë kulturore!

Përputhshmëria e punimeve me projekt dhe specifikimet teknike

1. **Investitori (Poseduesi i lejes)** - përgjegjës për mbarëvajtjen e projektit, delegon përgjegjësitë te kontraktuesit ekzekutues dhe mbikqyrës.
2. **Punëkryesit** - përgjegjës për cilësinë e realizimit të punëve , prandaj duhet të sigurojnë cilësinë e ndërtimit në relacion me projektin, standardet e punës dhe materialeve, dhe rregullativën e kërkuar.
3. **Mbikqyrësit e fazave** - sigurojnë që puna e punëkryesve të kryhet sipas kërkesave teknike e rregullative.
4. **Inspektori** - përgjegjës për realizimin e projekteve sipas lejes ndërtimore dhe standardeve të definuara në rregullativën shtetërore.

Kontrolli i cilësisë së materialeve dhe ekzekutimit, procedurat e testimit dhe inspektimeve gjatë realizimit

- Puna sipas Specifikimeve Teknike (ST)
- Sigurimi i atesteve nga prodhuesit e materialit.
- Dëshmitë e kontrollit të materialit nga laboratorit para vërjes në vepër.
- Dëshmi kontrolli të materialit nga laboratorit pas vërjes në vepër.
- Matjet specifike me instrument të sistemit të instalimeve (uji, rryma, ngrohja).
- Testimit provues të pajisjeve eventuale (sipas specifikave të prodhuesit).
- Dëshmi e përshkruar në Ditarin e ndërtimit (ose formular të posaçëm)
 - Kontrollimi vizual i punës
 - Kontrollimi manual i pozicioneve
 - Puna e pozicionit është fotografuar
- Dëshmi të regjistruara të pozicioneve të punuara me mangësi.
- Dëshmitë e përmirësimit të këtyre mangësive.

Testimet dhe Inspektimet në Projektet e ndërtimit

Objektivat e inspektimit dhe kontrollit të cilësisë së punimeve janë:

- Rritja e jetëgjatësisë, qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të strukturave
- Zvogëlimi i defekteve gjatë punimeve dhe reduktimi i ndërhyrjeve
- Korrigjimi i punimeve jo adekuate, si dhe i kostove të mirëmbajtjes
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së punimeve.
- Ruajtja e reputacionit të ndërmarrjes/kontraktorit për cilësi.

Çka duhet të inspektohet në ndërtim?

- **Materialet:** Inspektimi dhe kontrolli i cilësisë për të siguruar që materialet e vendosura në objekt janë në përputhje me specifikacionet e projektit.
- **Punimet:** Inspektohen për të siguruar që operacionet dhe aktivitetet e pozicionit të caktuar dhe materialet e përdorura, janë në përputhje me specifikacionet teknike.
- **Pajisjet:** Inspektohen për të siguruar që pajisjet e blera dhe të montuara janë në përputhje me specifikacionet e projektit dhe të furnitorit.
- **Pranimi i punimeve të kompletuara:** Pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, inspektohet nëse çdo pozicion është realizuar sipas projektit, si dhe verifikohet përputhshmëria e të gjithë objektit me projektin.

Kontrolli i materialeve dhe pajisjeve

Dy lloje kryesore të inspektimeve:

a) *Inspektimet në vendin e furnizimit*

b) *Inspektimet në vendpunishte*

a. Inspektimet në vendin e furnizimit: Lënda e parë dhe produkti inspektohet në vendin e furnizimit ose të prodhimit, që të eliminohet mundësia e sjelljes së materialeve jo adekuate në kantier.

Njësoj vlen edhe për pajisjet e porositura.

b. Inspektimet në kantier/punishte: Inspektimet në kantier/punishte janë të vazhdueshme dhe kryhen gjatë gjithë procesit të realizimit të punimeve.

Planifikimi i Inspektimit të kontrollit të cilësisë (KC)

Punimet: Planifikimi i inspektimeve për kontrollin e cilësisë realizohet me Planin e KC që përmban të dhënat për pozicionet që kontrollohen, metodologjinë e kontrollit, pajisjet, kohën.

Inspektimet urgjente: Kur identifikohen defekte që rrjedhin nga përdorimi i materialeve jo adekuate ose ekzekutimi i pasaktë i punimeve.

Inspektori është i obliguar të verifikojë që kontraktori ka realizuar përmirësimet e kërkuara sipas vërejtjeve të dhëna, si dhe të sigurohet që të njëjtat mangësi të mos përsëriten në të ardhmen.

Procedurat e testimit dhe verifikimit: Para fillimit të punimeve, inspektori dhe kontraktori duhet të arrijnë marrëveshje lidhur me procedurat e testimit dhe verifikimit, në përputhje me ST dhe standardet në fuqi për ekzekutimin dhe testimin e punimeve.

Menaxhimi i progresit, kohës dhe kostos

- Plani dinamik ndihmon koordinimin e aktiviteteve dhe caktimin e planit të inspektimeve,
- Niveli i cilësisë së planit dinamik është çështje e brendshme ndërmjet poseduesit të lejes dhe punëkryesit,
- Sa më detal të jetë plani dinamik i ndërtimit aq më të sakta dhe të qarta janë obligimet e pjesëmarrësëve ne projekt (Investitori për pagesa, Organi mbikqyrës per testime, inspektorati për vizita, furnitorët për materiale etj)
- Kontraktori është i obliguar që para fillimit të punimeve të paraqes planin dinamik,
- Planet e furnizimit me material, të financave dhe fuqisë punëtore janë opcionale.


Menaxhimi i kohës – Dinamika e ndërtimit

Plani Dinamik

No.	Activity	2012				2013												2014							
		9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	1	2	3	4	Q2	Q3	Q4	
1	Kontrata	◆																							
2	Fillimi i projektit	◆																							
Aktivitetet para-ndërtimit																									
3	Gjeodezia		■																						
4	Punët përgatitore		■																						
5	Dokumentacioni në punishte		■																						
6	Plani dinamik		■																						
Fazat e ndërtimit																									
7	Piketimi dhe inspektimi i lokacionit		■	◆																					
8	Punët nën nivelin e tokës			■	■																				
9	Struktura					■	■	■	■	■	■	■	■	■	■										
10	Instalimet e rrymës						■	■	■	■	■	■	■	■	■	■									
11	Instalimet e ujit dhe kanalizimit						■	■	■	■	■	■	■	■	■	■									
12	Instalimet e ndrohjes dhe ventilimit								■	■	■	■	■	■	■	■									
13	Punët finale											■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
14	Mbrojtja nga zjarri													■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
18	Kërkesa për certifikatën e përdorimit																								◆


Menaxhimi i kohës – Përcillja e dinamikës së ndërtimit

Përcjellja e Dinamikës së ndërtimit




Plani dinamik dhe financiar i projekteve të ndërtimit

- Planet financiare të projekteve të ndërtimit që janë ne formë të S lakoreve.



Planet dinamik të resurseve

Periudha kohore		Fuqia Punëtore													
		01-2023	02-2023	03-2023	04-2023	05-2023	06-2023	07-2023	08-2023	09-2023	10-2023	11-2023	12-2023	01-2024	02-2024
Planifikimi		35	88	112	124	143	143	143	143	143	143	123	123	99	75
Realizimi		28	61	79	79	102	102	102	102	81	81	81	81	102	102
Site Engineer	Plan	4	4												
	Actual	4	4												
QA/QC Engineer	Plan	2	2												
	Actual	1	1												
Foreman	Plan	1	8	10	10	13	13	13	13	13	11	11	9	6	
	Actual	1	4												
Skilled Workers	Plan	22	36	56	62	68	68	68	68	68	68	55	55	41	32
	Actual	16	30	36	36	48	48	48	48	45	45	45	45	48	48
Workers	Plan	6	38	38	44	53	53	53	53	53	53	49	49	41	29
	Actual	6	22	32	32	40	40	40	40	24	24	24	24	40	40



Dokumentacioni në vendndërtim

- Leja ndërtimore (preferohet kopje e noterizuar)
- Projektet teknike - dokumentacioni teknik i vulosur nga organi kompetent.
- Projekti i rregullimit të punishtes dhe Plani dinamik i punëve
- Pëlqimet e kyqjeve në infrastrukturën publike: rryma, uji, ngrohja, etj
- Kontrata në mes të poseduesit të lejes ndërtimore dhe punëkryesit
- Vendimet (udhëheqësi i punëve / inxhinierët mbikëqyrës të fazave)
- Ditari ndërtimor dhe Libri i ndërtimit
- Dokumentet dhe dëshmitë për kualitetin e produkteve dhe pajisjeve
- Njoftimet dhe Protokollet e kontrollimit të punëve sipas fazave
- Ndryshimet eventuale në projekt
- Plani për siguri dhe mbrojtjen e shëndetit i bazuar në metodologjinë e riskut
- Njoftimi për hapjen e punishtes (kërkesë nga Inspektorati i punës)

Dokumentet tjera relevante

- Librat e regjistrit të punëtorëve,
- Dokumentet e furnizimit me material,
- Procesverbalet e mbledhjeve, raportet, dhe dokumentat tjerë të punës,
- Marrëveshja me gjeodetin e licencuar,
- Marrëveshja me laboratorin e licencuar për kontrollin e materialit,
- Marrëveshja me furnizuesin e licencuar të betonit (nëse kërkohet),
- Formularët përkatës për regjistrimin e aktiviteteve të caktuara si p.sh. lëndimet eventuale të punëtorëve,
- Marrëveshja e deponimit të inerteve,
- Dokumente tjerë për punë.


Ditari i ndërtimit

- Regjistron aktivitetet ditore në punishte për evidentimin e përputhshmërisë së procesit të ndërtimit me projektet, marrëveshjet, rregulloret teknike dhe praktikat profesionale.
- Plotësimi bëhet nga palët e përfshira në projekt, ku secila palë ka të caktuar vendin ku plotëson ditarin, dhe llojin e informatave që duhet të regjistrojë.
- Kur punishtja përfshin disa objekte ose faza, mund të mbahet një ditar i përgjithshëm për rrjedhën e përgjithshme të ndërtimit, dhe ditarë të veçantë për faza apo pjesë specifike të projektit. Ditarin e përgjithshëm e mban udhëheqësi kryesor i ndërtimit, ndërsa ditarët e veçantë mbahen nga udhëheqësit përgjegjës për punët përkatëse.

Rregullat e plotësimit të Ditarit/Librin të ndërtimit

1. Ditari dhe libri i ndërtimit fillojnë me ditën e dhënies së njoftimit për fillimin e ndërtimit e cila i dërgohet organit kompetent deri të përfundohet ndërtimi dhe lëshohet certifikata e përdorimit;
2. Çdo fletë e ditarit apo librit të ndërtimit shënohet me numrin rëndor;
3. Ditari i ndërtimit (nëse është kopje e gatshme) duhet t'jetë i lidhur dhe nuk lejohet plotësimi i tij i më vonshëm apo zëvendësimi i pjesëve të tij. Ditari elektronik plotësohet çdo ditë në dy kopje dhe nënshkruhet nga palët e involvuara;
4. Ditari dhe libri i ndërtimit plotësohen me ngjyrë;
5. Teksti i gabuar nuk fshihet por i bihet vizë që të mbetet i lexueshëm. Fleta apo pjesa e fletës ku është gabuar shënjëzohet me 'x' dhe nuk guxon të zhduket por mbetet si e tillë në ditar;
6. Për përmirësimet e pjesëve të gabuara shënohet përmirësimi, data dhe nënshkruhen;
7. Plotësimet regjistrohen si shënime të reja në të cilat regjistrohet data kur ato janë shënuar;
8. Mbi rreshtat e papërdorur duhet të shënohet vizë ashtu që të njëjtat mos të ketë mundësi të përdoren në ditët e ardhshme;
9. Ditari dhe libri i ndërtimit përgatiten në dy kopje, ku njërin e merr mbikëqyrësi;
10. Poseduesi i lejes obligohet t'a ruaj ditarin dhe librin e ndërtimit për 10 vite pas ndërtimit.

Shembull i Librit të ndërtimit

LIBRI NDËRTIMOR			Faqja nr.	15	
			Fleta nr.	15.1	
Vend ndërtimi:	Prishtinë/Aktash	Objekti:	Banesa 3	Faza:	Struktura
Përshkrimi i punëve: Furnizimi i materialit dhe betonimi i themeleve shiritore me beton të armuar C30. Në çmim të parashihet punimi i pahive.					
Poz/Parrallogji:	4.2	Nj.m. m3	Çmimi njësi: 125 €	Llogaria	
Normativi nr.		Skica nr.	Sasia: 154.45 m3	Për Fazë	Total
<p>Bartja:</p> <p>$2 * 12.0 * 0.4 * 0.5 = 4.80$</p> <p>$10.0 * 0.4 * 0.5 = 2.0$</p> <p>$6 * 4.0 * 0.4 * 0.5 = 4.80$</p> <p>Total: 11.6 m3</p> 					

Për barjete:

SASIA TOTALE E REALIZUAR PËR KËTË KALKULIM:

11.60

Punëkryesi/Kontraktuesi:

Mbikqyrësi:

(data dhe nënshkrimi)

(data dhe nënshkrimi)

Inspektimi final - Protokoli

VËREJTJE: Informatat në këtë listë kontrolli janë sipas kërkesave të ligjit Nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 27 dhe kërkesë e neni 28 për inspektim final.

A verifikojnë të dhënat nga protokollet e nënshkuara të inspektimeve (të kryera nga inspektori apo poseduesi/kontraktuesi i lejes) ose ndonjë dëshmi tjetër se:	Po	Jo
1. Kërkesat e lejes së ndërtimit janë zbatuar		
2. Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave		
3. Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë		

Nëse përgjigjet ndaj të gjitha pyetjeve të lartshënuara janë PO, atëherë lëshohet raporti për inspektimin final dhe që aplikuesi sipas procedurës të aplikoj për Certifikatë të Përdorimit.

LN: Neni 28. Kërkesa për lëshimin e certifikatës së përdorimit

3. Inspekcioni ndërtimor ka të drejtë të bëjë inspektimin final të vend ndërtimit dhe poseduesi i lejes ndërtimore duhet t'i sigurojë qasje të arsyeshme në vend ndërtim.

Dokumentacioni që duhet t'i sigurohet inspektorit për inspektim final

1. Ditari i ndërtimit i plotësuar çdo ditë me fotografitë
2. Libri i ndërtimit për të gjitha pozicionet e punës
3. Të gjitha protokollet e kompletuara të fazave dhe pozicioneve eventuale
4. Atestet dhe rezultatet e kontrollit të cilësisë
5. Elaborati gjeodezik i piketimit të objektit dhe objektit të realizuar
6. Ndryshimet eventuale në projekt - projekti sipas realizmit.
7. Autorizimin për shqyrtimin e tokëzimit dhe rrufepritësve
8. Certifikatën e performancës energjetike të ndërtesës
9. Raporti shqyrtues/testimet e pajisjeve kundër mbrojtjes nga zjarri
10. Certifikatën e trupës inspektuese të ashensorit-ëve / pranimin teknik
11. Autorizimin për shqyrtimin e rrjeteve të hidrantëve
12. Pëlqimin përfundimtar për kyqje në rrjetin e ujit dhe kanalizimit dhe rrymë
13. Pëlqimin përfundimtar për kyqje në rrjetin e ngrohjes (nëse ka)

Dokumentacioni tjetër që mund të kërkohet

1. Vendimi i lejës ndërtimore
2. Pëlqimi mjedisor (nëse kërkohet)
3. Vendimi i lejës së rrënit (nëse ka)
4. Licencat e inxhinierëve mbikëqyrës dhe udhëheqësit
5. Licenca e gjeodetit
6. Kontrata mes poseduesit të lejes ndërtimore dhe punëkryesit
7. Vendimi mbi emërtimin e udhëheqësit të vend ndërtimit
8. Vendimi mbi emërtimin e inxhinierëve mbikëqyrës të fazave të ndërtimit
9. Dokumente tjera relevante.

Procedurat për Certifikatën e Përdorimit (CP) - Formulari

- Numrin vrojtues të lejes ndërtimore.
- Të dhënat e aplikuesit për CP:
 - Nëse aplikuesi është pronar apo i autorizuar
 - Emri, mbiemri, numri identifikues, adresa, telefoni dhe e-maili
 - Deklarata e dëshiron të njoftohet përmes telefonit apo emailit.
- Evidentimin e kategorisë së ndërtimit.
- Adresën e vend ndërtimit ose informatat për lokacionin e objektit për të cilin kërkohet certifikata e përdorimit.
- Të dhënat kadastrate (zona, ngastra, koordinatat GPS për lokacion dhe objekt).

Kërkesat e listës kontrolluese (Shtojca 5):

1. Incizimin gjeodezik i objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur (KRef 01)
2. Nëse pagesat janë bere me këste, dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë.
3. Përcaktimi i adresës së objektit.
4. Protokollet
5. Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve (të dorëzuara në pranimin final).
6. Nëse janë bërë modifikime gjatë ndërtimit, dorëzohet projekti i “NDËRTIMIT TË KRYER” ku tregohen modifikimet (Projekti “As Built”).

Kërkesat e listës kontrolluese (Shtojca 6. sipas UA18/2013)

1. Incizimin gjeodezik i objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur (KRef 01)
2. Fotografi për pozicione të caktuara të punëve janë kryer sipas projektit
3. Nëse pagesat janë bere me këste, dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë.
4. Përcaktimi i adresës së objektit.
5. Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve (të dorëzuara në pranimin final).
6. Raport të realizimit të punëve ndërtimore nga secili inxhinier mbikëqyrës i fazës se ndërtimit, me të cilin merr përsipër se punët janë kryer plotësisht sipas projektit, në përputhje të plotë me Lejen e Ndërtimit.
7. Diplomat e inxhinierëve që kanë bërë mbikëqyrjen e fazave të ndërtimit
8. Nëse janë bërë modifikime gjatë ndërtimit, dorëzohet projekti i “NDËRTIMIT TË KRYER” ku tregohen modifikimet.

RAPORTI FINAL

1. Të dhënat informative mbi objektin të cilat i definojnë leja ndërtimore
2. Të dhënat informative mbi palët e involvuara në projekt
3. Një përshkrim të punëve ndërtimore për të cilat lëshohet certifikata e përdorimit
4. Deklaratat inxhinierëve mbikëqyrës të fazave për përputhshmërinë e ndërtimit
5. Info mbi dinamikën e punëve: fillimi, rrjedha dhe përfundimi i ndërtimit
6. Deklaratën e gjeodetit se matjet gjeodezike janë në përputhje me projektet
7. Regjistrin e dokumenteve të kontrollit të cilësisë së materialit
8. Të dhëna në lidhje me aktivitetet specifike gjatë ndërtimit
9. Deklaratën e prodhuesit të materialit apo vulosjen e dokumentacionit të produktit
10. Të dhënat në lidhje me ndryshimet nga projekti kryesor
11. Të dhënat në lidhje me mangësitë gjatë realizimit të punëve dhe evitimi i tyre.
12. Të dhëna tjera eventuale në lidhje me mbikëqyrjen e punëve të realizuara.

Rrg 06/2017 - “Për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtimet të përkohshme apo mobile.” - Roli i Koordinatorit për SSHP (person i certifikuar)

- Emërimi i koordinatorit për M&S gjatë projektimit
- Emërimi i koordinatorit për M&S gjatë ekzekutimit
- Hartimi i Planit për siguri dhe shëndet në punë (SSHP)
- Njoftimi ‘Regjistrimi i ndërtimit’ - në Inspektorat /shfaqet në vendndërtim
- Përgatitja e dokumentit informues të SSHP me karakteristikat e projektit
- Koordinatori organizon e mbikqyr masat për SSHP gjatë ekzekutimit të punëve
- Punëdhënësi duhet t’i zbatojë masat për SSHP në konsultim me koordinatorin
- Punëdhënësi obligohet të informojë të punësuarit dhe palët që frekuentojnë në punishte për masat e M&S dhe rreziqet eventuale (njoftime, shenjzime, plane, dokumenta) dhe organizohet trajnimi për t’i përcjellur këto udhëzime
- Kërkesa tjera specifike dhe procedura të shënuara në shtojcat e Rregullores!

Ligj 06 L-079 Për Eficiencë të energjisë

- Promovimi dhe përmirësimi i eficiencës së energjisë
- Objektivat në fushën e eficiencës së energjisë:
 - largimi i barrierave për promovimin e eficiencës së energjisë;
 - Përdorimi i teknologjive, matjes dhe kontrollit, dhe menaxhimit të energjisë;
 - Promovimi i përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë.
 - Mekanizmat financiar stimulues
 - Bashkëpunimi mes konsumatorëve , prodhuesve, furnizuesve, dhe institucioneve.
 - Auditimet energjetike.
 - Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së konsumatorëve;
 - Promovimi i hulumtimeve themelore dhe aplikative.
- Auditimi i objekteve në lidhje me eficiencën e energjisë!

Rregullativa për Mbrojtja e mjedisit

1. Sipas Ligjit për Mbeturina 02/L-30 (2008) mbeturinat ndërtimore Ijanë Mbeturina speciale
2. Plotësohet/shfuqizohet nga Ligji 04/L-060 Për mbeturina - Shtojca (2012), dhe
3. Ligji 08/L-071 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-060 për mbeturina.
4. UA (MMPH) 07/2015 Për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi I objekteve ndërtimore.
5. LIGJI Nr. 03/L-214 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS.

Pyetje & Përgjigje

Faleminderit për vëmendjen!

www.oirk.org | info@oirk.org | +383 (38) 606 602